

BRUTO PRODHIMI VENDOR

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) për herë të parë publikon përlllogaritjet paraprake të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) me çmime aktuale për vitet 2004 - 2006. Përlllogaritjet janë përpiluar nga Divizioni i Llogarive Kombëtare i ESK me asistencë teknike nga Departamenti për Statistika i FMN-së dhe Projektit të BE “Mbështetje e mëtutjeshme Entit Statistikor të Kosovës”. Metodologjia e përdorur për kalkulimin e BPV është sipas koncepteve dhe përkufizimeve të Sistemit të Llogarive Kombëtare 1993 (1993 SNA).

Ekzistojnë tri qasje për matjen e BPV: prodhimi, shpenzimet dhe të ardhurat. BPV, sipas qasjes së prodhimit, është shuma e vlerës së shtuar e të gjitha njësive prodhuese rezidente, plus tatimet e zvogëluara për subvencionet në prodhim, të cilat nuk janë të përfshira në vlerësimin e outputit. BPV, sipas qasjes së shpenzimeve, është shuma e përdorimit final të mallrave dhe shërbimeve (të gjitha përdorimet përveç konsumit të ndërmjetëm) e matur në procesin e blerjes, e zvogëluar për vlerën e importeve të mallrave dhe shërbimeve. BPV, sipas qasjes së të ardhurave, është shuma e të ardhurave primare të shpërndara nga njësitë rezidente të prodhimit.

Për shkak të mungesës së të dhënave ekonomike dhe kualitetit jo aq të mirë, përlllogaritja e Bruto Prodhimit Vendor në Kosovë është subjekt i punës së mëtejme. Mungesa e të dhënave është më shumë e shprehur në fushën e prodhimit dhe të ardhurave. Për këtë arsye, BPV është përlllogaritur së pari me qasjen e shpenzimeve, për shkak se të dhënat nga sektori fiskal dhe i jashtëm janë mjaft të sakta.

Vlerësimet finale të BPV për periudhën 2004-2006 do të jenë të gatshme pas vlerësimit të Bruto Prodhimit Vendor me qasjen e prodhimit, duke i përdorur të gjitha të dhënat administrative dhe statistikore, si rezultat i objektivave të ESK për përmirësimin e kualitetit, përfshirjes dhe krahasimit ndërkombëtar

ESK ka përlllogaritur BPV-në duke përdorur qasjen e shpenzimeve. BPV me çmimet e tregut është e barabartë me shumën e shpenzimeve të konsumit final (të ekonomive shtëpiake, institucioneve qeveritare dhe institucioneve jo-profitabile të cilat iu shërbejnë ekonomive shtëpiake), formimin e bruto kapitalit dhe net eksportit të mallrave dhe shërbimeve (eksportet të zvogëluara për importet).

Konsumi final matet si shuma e konsumit final të ekonomive shtëpiake, konsumit final të institucioneve jo-profitabile të cilat iu shërbejnë ekonomive familjare (NPISHs) dhe konsumit final të qeverisë. Konsumi final i ekonomive shtëpiake në Kosovë është përlllogaritur duke përdorur qasjen e rrjedhjes së mallrave, bazuar në të dhënat e disponuara nga anketa e buxhetit të ekonomive shtëpiake, importet, të dhënat administrative, të dhënat për prodhimin, etj.

Formimi i bruto kapitalit është shuma e formimit të bruto kapitalit fiks dhe ndryshimeve në inventar. Eksporti i mallrave dhe i shërbimeve përbëhet nga transaksioni në mallra dhe shërbime (shitjet, shkëmbimet, dhuratat ose grantet) nga rezidentët tek jo-rezidentët. Importi i mallrave dhe shërbimeve përbëhet nga transaksioni në mallra dhe shërbime (blerjet, shkëmbimet, dhuratat dhe grantet) nga jo-rezidentët tek rezidentët. Të dhënat për importin dhe eksportin e shërbimeve janë marrë nga statistikat e bilancit të pagesave, të përpiluara ne Bankën Qendrore të Kosovës (BQK).

BPV-ja në Kosovë është rritur gjatë periudhës 2004-2006 nga 3.006,5 Euro në 3.191,7 milion Euro. BPV për kokë banori është rritur nga 1.473 euro në 2004, në 1.520 euro në 2006.

Tabela 1: BPV me çmime aktuale (të dhënat provizionale)

	(në milion Euro)		
	2004	2005	2006
BPV me çmime aktuale	3.006,5	3.068,4	3.191,7
Shpenzimet e konsumit final	3.298,6	3.434,7	3.560,3
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	2.539,5	2.705,8	2.864,7
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	735,5	705,2	670,8
Qeveria e Kosovës	355,5	329,2	340,8
Donatorët (pagat)*	380,0	376,0	330,0
Të punësuar te huaj	248,0	258,0	213,0
Të punësuar vendor	132,0	118,0	117,0
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	23,5	23,7	24,8
Formimi i bruto kapitalit	701,2	722,2	798,3
Formimi i bruto kapitalit fiks	583,6	592,8	657,1
Ndryshimet në inventar	117,7	129,4	141,2
Eksporti neto	-993,3	-1.088,6	-1.166,9
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	212,4	214,7	285,6
Eksporti i mallrave	56,9	56,3	110,8
Eksporti i shërbimeve	155,5	158,4	174,8
Importi i mallrave dhe shërbimeve	1.205,7	1.303,3	1.452,5
Importi i mallrave	1.028,7	1.100,2	1.251,9
Importi i shërbimeve	177,0	203,1	200,6
Popullsia (000)¹	2.041	2.070	2.100
BPV për kokë banori (Euro)	1.473	1.482	1.520

Përbërësi kryesor i BVP është konsumi final i ekonomive shtëpiake, që është rritur nga 2.539,5 milion euro në 2004 në 2864,7 milion euro në 2006. Formimi i bruto kapitalit ka kontribuar me 25 për qind në BPV në vitin 2006. Shpenzimet e përgjithshme qeveritare në periudhën 2004 – 2006 kanë përfaqësuar 24,5-21 për qind të BPV-së.

* Përfshinë pagat e të punësuarve rezident të UNMIK-ut (personelit lokal dhe të huaj të cilët qëndrojnë më gjatë se një vit); shih shtojcën 1.

Tabela 2: Struktura e BPV sipas shpenzimeve (%)

	2004	2005	2006
BPV me çmime aktuale	100,0	100,0	100,0
Shpenzimet e konsumit final	109,7	111,9	111,5
Shpenzimet e konsumit final te ekonomive shtëpiake	84,5	88,2	89,8
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	24,5	23,0	21,0
Qeveria e Kosovës	11,8	10,7	10,7
Donatorët (pagat)	12,6	12,3	10,3
Të punesuar te huaj	8,2	8,4	6,7
Të punesuar vendor	4,4	3,8	3,7
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	0,8	0,8	0,8
Formimi i bruto kapitalit	23,3	23,5	25,0
Formimi i bruto kapitalit fiks	19,4	19,3	20,6
Ndryshimet në inventar	3,9	4,2	4,4
Eksporti neto	-33,0	-35,5	-36,6
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	7,1	7,0	8,9
Eksporti i mallrave	1,9	1,8	3,5
Eksporti i shërbimeve	5,2	5,2	5,5
Importi i mallrave dhe shërbimeve	40,1	42,5	45,5
Importi i mallrave	34,2	35,9	39,2
Importi i shërbimeve	5,9	6,6	6,3

Prishtinë, Nëntor 2008

Kryeshefi Ekzekutiv i ESK
Avni Kastrati

Shtojca nr 1

Trajtimi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në Statistikat e Llogarive Kombëtare

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) është njësi e Kombeve të Bashkuara, është organizatë ndërkombëtare. Si rregull, *Sistemi i Llogarive Kombëtare 1993 (SLLK 1993)* i konsideron organizatat ndërkombëtare si ofrues të shërbimeve në mbarë botën sipas marrëveshjeve kontraktuese dhe si të tilla si jo-rezidentë të asnjë shteti (*SNA 1993*, paragrafi 4.164(b) dhe 4.165). Megjithatë, UNMIK-u është organizatë ndërkombëtare e veçantë për dy arsye. E para, është krijuar për të ofruar shërbime qeveritare *vetëm* për rezidentët e Kosovës, e jo botës si tërësi. E dyta, ishte caktuar të qëndroje për një periudhë të caktuar e jo të papërcaktuar.

Me këtë varg të fakteve, ekzistojnë dy qasje të mundshme për të trajtuar UNMIK-un në llogaritë kombëtare të Kosovës. Sipas vështrimit të parë, të dhënat e publikuara e trajtojnë UNMIK-un si organizatë e veçantë ndërkombëtare, e cila kryen shërbime qeveritare për rezidentët. Sipas vështrimit të dytë, i cili mund të zbatohet në përpilimin e llogarive kombëtare, është që UNMIK-u, si organizatë e rëndomtë ndërkombëtare, është duke ofruar shërbime për botën në tërësi.

Sipas trajtimit të parë, shërbimet që ndërlidhen me UNMIK-un konsiderohen që janë prodhuar brenda vendit, pasi që ato prodhohen dhe konsumohen brenda territorit ekonomik të Kosovës për përfitime të Kosovës. Si shërbime jo tregtare, vlera e tyre kalkulohet me kosto të prodhimit si shumë e:

- (a) kompensim i punonjësve *rezidentë* dhe konsum i kapitalit fiks; dhe
- (b) shpenzim i konsumit të ndërmjetëm për mallra dhe shërbime (me kosto të punonjësve *jorezident* të regjistruara si import i shërbimeve). Financimi i këtyre shërbimeve regjistrohet njëjtë sikurse transferet aktuale nga jashtë.

Sipas trajtimit të dytë, Bruto Prodhimi Vendor (BPV) i Kosovës nuk do të regjistrojë as prodhimin e as konsumin për shërbimet qeveritare të Kosovës që ndërlidhen me UNMIK-un. Në vend të kësaj, Kosova do të regjistronte fitimet e punonjësve rezident të UNMIK-ut në Kosovë si të ardhura primare nga jashtë.

Sipas trajtimit të parë, për gjëra tjera të barabarta, Bruto Prodhimi Vendor (BPV) i Kosovës do të përfshijë prodhimin e shërbimeve qeveritare që ndërlidhen me UNMIK-un, me cilindo financim nga jashtë që vazhdon të pasqyrohet si transfer aktual, për aq gjatë sa UNMIK-u i ofron këto shërbime. Deri atëherë kur qeveria e Kosovës merr përsipër ofrimin e këtyre shërbimeve, ndërsa ofrimi nga UNMIK-u zbret, zvogëlimi i BPV-së është rezultat i ndikuar nga rritja e BPV-së së mëhershme.

Sipas trajtimit të dytë, për gjera tjera të barabarta, deri atëherë kur qeveria e Kosovës të merr përsipër funksionet e UNMIK-ut, BPV-ja e Kosovës do të rritet dhe tregon rritjen e shërbimeve qeveritare. Derisa UNMIK-u i ul ndikimet e tij, të ardhurat primare nga jashtë do të ulen në mënyrë të njëtrajtshme. Çfarëdo ngritje në financim të jashtëm për të ndihmuar Qeverinë e Kosovës për të marr përsipër prodhimin e këtyre shërbimeve do të tregohet si ngritje në transfere aktuale nga jashtë.

Gjatë periudhës së tranzicionit, trajtimi i parë i UNMIK-ut, si organizatë e veçantë ndërkombëtare, prodhon GDP-në më të lartë për Kosovën sesa trajtimi i UNMIK-ut si organizatë e rëndomtë ndërkombëtare. Derisa ndikimi i UNMIK-ut zbret, përlllogaritjet e BPV-së nga të dy trajtimet do të jenë në nivel të njëjtë.